



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
AGJENCIA PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI
AGENCIJA ZA INFORMACIJE I PRIVATNOST
INFORMATION AND PRIVACY AGENCY



Nr. A-291-GJ/2022

Datë: 02.03.2022

Në mbështetje të nenit 21, 26 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 32 dhe 33 të Ligjit Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, nenit 29 të Ligjit Nr.05/L-087 për Kundërvajtje, Agjencia për Informim dhe Privatësi merr këtë:

V E N D I M

1. Shqiptohet gjobë ndaj Odës së Avokatëve të Kosovës, në shumën prej €3.000 (tremijë) siç parashihet në nenin 32 dhe 33 të Ligjit Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike.
2. Obligohet Oda e Avokatëve të Kosovës që shumën prej €3.000 (tremijë) ta paguajë në afat prej 30 ditësh, në xhirollogarinë e Agjencisë për Informim dhe Privatësi Nr.1000400070005127/ Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.
3. Në rast mospagese të gjobës së shqiptuar brenda afatit siç përcaktohet në pikën 2. Agjencia për Informim dhe Privatësi aplikon procedurën përmbaremore për në pajtim me Ligjin Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaremore.
4. Obligohet Drejtori Ekzekutiv të ndërmerr të gjitha veprimet e duhura për zbatim të këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Në bazë të nenit 20, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, Agjencia ka pranuar një ankesë nga zsh. X. X., me nr. të protokollit 291, të datës 21.12.2021, të ushtruar ndaj Odës së Avokatëve të Kosovës, për kufizimin e qasjes në kërkesën e parashtruar në këtë institucion publik, ndaj kërkesës së saj për qasje në dokumente publike të poshtëshënuara:

Informata statistikore lidhur me takimet e Këshillit Drejtues të OAK-së për 6 mujorin e parë të vitit 2021:

1. Statistika lidhur me takimet e Këshillit Drejtues të OAK-së dhe atë:
 - 1.1. Sa takime ka mbajtur Këshilli Drejtues (përfshirë numrin rendor të takimit dhe datën e takimit)?
 - 1.2. Sa është numri i vendimeve që Këshilli Drejtues ka marrë dhe cila është natyra e këtyre vendimeve?
2. Agjenda e takimeve të mbajtura të Këshillit Drejtues.
3. Procesverbalet e takimeve të Këshillit Drejtues të OAK-së.
4. Vendimet e Këshillit Drejtues të OAK-së.

Pas shqyrtimit të ankesës, Agjencia, përmes një shkrese njoftuese të datës 13 janar 2022, në pajtim me nenin 20, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, ka kërkuar nga zyrtari përgjegjës në Odën e Avokatëve të Kosovës, që ta njoftojë me arsyet e refuzimit të kërkesës për qasje në dokumente publike të zsh. X.X.

Më 19 janar 2022, Oda e Avokatëve të Kosovës, përkatësisht Drejtori Ekzekutiv z. X. X., ka njoftuar Agjencinë për Informim dhe Privatësi lidhur me arsyet e kufizimit të kërkesës për qasje në dokumente publike të palës ankuese. Në emailin e dërguar Oda e Avokatëve të Kosovës, njoftoi se për pikën 1 dhe 2 të dokumenteve, objekt kërkesë, është ofruar qasje e plotë. Ndërsa, për pikën 3 dhe 4 ka ofruar këtë arsyetim:

‘Lidhur me pyetjen nr. 3 që ka të bëjë me procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit Drejtues, ne kemi sqaruar kërkuuesin se bazuar në Ligjin 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 39 paragrafi 2, këto mbledhje janë të mbyllura për publikun, andaj procesverbalet e kërkuara janë derivat i diskutimeve që ndodhin brenda këtyre mbledhjeve. Andaj, nuk mund të konsiderohen dhe nuk janë dokumente publike, meqenëse publikimi i tyre nënkupton hapje të mbledhjeve që sipas ligjit janë të mbyllura për publikun.’

‘Lidhur me pyetjen nr. 4 që ka të bëjë me vendimet e Këshillit Drejtues, ne kemi kërkuar nga kërkuesi që të specifikojë se cilin dokument publik (vendim) dëshiron ta ketë dhe ne do t’ia ofrojmë pa hezitim derisa kërkesa që të jepen të gjitha vendimet pa specifikacione, por si tërësi, më tepër nënkupton një kërkesë për “kontroll” ose për të raportuar dhe jo kërkesë për t’u zbatuar Ligji për Qasje në Dokumente Publike.’

Pas shqyrtimit të arsyetimit të ofruar nga Oda e Avokatëve të Kosovës, Agjencia për Informim dhe Privatësi, më 24 janar 2022 ka nxjerrë Vendimin A-291/2022. Agjencia e ka aprovuar si të bazuar ankesën e palës dhe ka konstatuar se refuzimi i kësaj kërkesë nga Oda e Avokatëve të Kosovës nuk përmbushë asnjë nga kriteret e parapara nga neni 17, paragrafi 2, 3 dhe 5 të Ligjit Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike. Rrjedhimisht, Agjencia për Informim dhe Privatësi konstaton se arsyetimi i ofruar nuk e liron Odën e Avokatëve të Kosovës nga obligimi i ofrimit të dokumenteve objekt kërkesë, duke respektuar afatet ligjore që rrjedhin nga Ligji Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike. Në rast se dokumentet e kërkuara përmbajnë të dhëna personale të tepërta, ligji e parasheh mundësinë e pseudonimizimit ose anonimizimit të atyre të dhënave.

Ndërsa, sa i përket arsyetimit të Odës së Avokatëve se sipas Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, mbledhjet e Këshillit Drejtues të Odës së Avokatëve konsiderohen të mbyllura, andaj edhe dokumentet e prodhuara nga këto takime meritojnë të mbeten të mbyllura për publikun. Agjencia për Informim dhe Privatësi konsideron që sipas Ligjit Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, si ligj i veçantë, i cili rregullon këtë fushë specifike, procesverbali si dokument administrativ, nëse nuk i është nënshtruar klasifikimit përmes një vendimi të posaçëm nga autoriteti i klasifikimit, nuk do të duhej të mbahej i mbyllur për publikun, e aq më pak sipas një kërkesë. Për më tepër, pohimi arsyetues i përfaqësuesve të Odës së Avokatëve për mohimin e qasjes në këto procesverbale nuk mbështetet në asnjërin kriter të paraqitur në paragrafin 2 të nenit 17 të Ligjit Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, për t'u konsideruar si i bazuar refuzimi i qasjes në dokumentet publike, objekt kërkesë nga pala.

Oda e Avokatëve të Kosovës, më 31 janar 2022, ka dërguar një shkresë në drejtim të Agjencisë për Informim dhe Privatësi, ku kanë sqaruar arsyet e refuzimit të vendimit A-291/2022. Në këtë shkresë drejtuar Agjencisë, Oda e Avokatëve të Kosovës, refuzimin e realizimit të këtij vendimi e arsyeton me faktin se në bazë të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 39, paragrafi 2, mbledhjet e organit kolegjal janë të mbyllura, përveç kur parashikohet ndryshe nga legjislacioni në fuqi. Tutje, OAK ka deklaruar se provesverbalet e këtyre takimeve janë derivat i diskutimeve dhe se publikimi i tyre do të nënkuptonte hapje të mbledhjes.

Ndërsa për pikën numër 4 të dokumenteve, objekt kërkesë, lidhur me vendimet e Këshillit Drejtues të Odës së Avokatëve të Kosovës, refuzimi është arsyetuar me faktin se “është në kundërshtim me proporcionalitetin dhe ekonimizimin, pasi që shumica absolute e këtyre vendimeve janë të zakonshme p.sh ndryshimi i adresave të avokatëve, kërkesa për pushim lehonie, regjistrimet dhe ç’regjistrimet (pezullimet) e avokatëve (janë të dhëna të publikuara në web faqe të OAK-së)” dhe ka deklaruar se do të ofrojë qasje në rast se kërkesa specifikohet për ndonjë vendim, mirëpo jo edhe për të gjitha vendimet.

Agjencia për Informim dhe Privatësi, me qëllim të shqyrtimit të mëtejshëm të ankesës nr. 291, ka ftuar palët në një seancë dëgjimore. Seanca dëgjimore u mbajt më 7 shkurt 2022, ku të ftuar ishin: Drejtori i Përgjithshëm i Odës së Avokatëve të Kosovës z. X. X., dhe përfaqësuesi i palës ankuese z. X. X.. Përfaqësuesi i OAK-së Z. X, deklaroi se qasja në procesverbale refuzohet për arsyet e cekura më lart. Ndërsa, sa i përket vendimeve të Këshillit Drejtues të OAK-së, ato do të ofrohen vetëm nëse kërkesa specifikohet për ndonjë vendim.

Si konkluzion i kësaj seance dëgjimore, doli se AIP do të detyrohet të vazhdojë me procedurën e saj të brendshme për shqyrtimin e një ankese dhe marrjen e veprimeve të përcaktuara në ligj.

Siç është përshkruar në arsyetimin e lartcekur dhe bazuar në nenin 32 dhe 33 të Ligjit Nr.06/L-081 për Qasje e në Dokumente Publike, Agjencia ka marrë vendimin e paraqitur në dispozitiv.

Nënshkruar më datë 02.03.2022

Zyrtar i Lartë për Shqyrtimin e Ankesave

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqesë padi për kundërshtim në gjykatën kompetente për çështje administrative, brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga data në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Z. X. X. – Drejtor Ekzekutiv / Oda e Avokatëve
- Zsh. X. X. / IKD
- Arkivit të Agjencisë